



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:141395

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05811448

KA.nr.397/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina” SH.A., me seli në Prishtinë adresa rruga “Hazir Shala” nr.4, përfaqësuar sipas autorizimit nga A.M., kundër të paditurës Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me numër 01Nr.33-344/2020 i datës 06.07.2020 dhe Vendimi nr.prot. 410/20, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 19.04.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit sipas autorizimit A.M., ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 21.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina” SH.A., me seli në Prishtinë
- II. ANULOHEN vendimi me numër 01Nr.33-344/2020 i datës 06.07.2020 lëshuar nga organi i shkallës e parë në Inspektorat të Punës dhe Vendimi nr.prot. 410/20, i organit të shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës, si të kundërligjshme.
- III. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

### Historiku procedural

Më datë 23.10.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 1764/2020, kundër të paditurit Inspektorati i Punës, për shkak të anulimit të vendimit me numër 01Nr.33-344/2020 i datës 06.07.2020 lëshuar nga shkalla e parë në Inspektorat të Punës dhe Vendimi nr.prot. 410/20, të lëshuar nga organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës, me propozim që gjykata të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe të anuloj vendimi me numër 01Nr.33-344/2020 të datës 06.07.2020 lëshuar nga organi i shkallës së parë në Inspektorat të Punës dhe Vendimi nr.prot. 410/20, të lëshuar nga organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 397/22.

Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit A.M. sipas autorizimit, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, ftesën për në seancë i padituri e ka pranuar më datë 25.03.2024, nuk prezenton ne seance, konform nenit 41 të LKA-së, seanca u mbajt ne mungese te palës se ftuar ne menyre te rregullt.

### Pretendimet e paditësit

Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Bordi i Drejtorëve gjatë mbledhjes së jashtëzakonshme më datë 07.04.2020 ka marr vendim për shkarkim nga pozita e zëvendës kryeshefit ekzekutiv Z.K.Zh., në përputhje të plotë me ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përkatësisht neni 18, 21, 23. Bordi i përkohshëm i drejtorëve pas caktimit të agjendës për këtë mbledhje të jashtëzakonshme ka njoftuar edhe Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe nuk ka pasur asnjë reagim nga kjo njësi.

Tutje ka shtuar se Bordi i përkohshëm i drejtorëve ka vepruar drejtë dhe në përputhje me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike në kompetencat detyrat dhe përgjegjësitë që i janë dhënë. Inspektorati i Punës në të njëjtin vendim refuzon ankesën e ankuesit si të pa bazuar ndërsa pjesën tjetër të ankesës për sistemim në ndonjë vend tjetër të punës e bazon në ligj pa ndonjë argument, duke mos marrë parasysh faktet se ankuesi pa asnjë kriter dhe bazë

ligjore kishte ushtruar pozitën e zëvendës kryeshefit ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike KRU “Prishtina” SH.A.1 Në vendimin e Inspektoratit të punës është përmendur se ankuesi në ankesë thirret në nenin 41 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 për sistemim në një pozitë tjetër, ndërsa neni 41 i Ligjit të Punës rregullon një aktivitet tjetër që nuk ndërlidhet fare me rastin në fjalë.

Përfundimisht ka deklaruar se i padituri ka bërë shkelje procedurale në nxjerrjen e Vendimit duke u bazuar në Ligjin e punës Nr03/L-212 përkatësisht neni 82 paragrafi 2, ngase nuk i ka marr për bazë shkeljet për të cilat është marrë vendimi i ankimuar të cilat janë shkelje të rënda. Inspektorati i Punës në vendimin e shkallës së dytë në të cilin i jep të drejtë ankuesit Z.K.Xh. që të kthehet në vendin e tij të punës si zëvendës kryeshef ekzekutiv, i ka tejkualuar kompetencat të cilat i janë dhënë me ligjin për inspektoratin e punës dhe duke shkaktuar kundërthënie të theksuara në mes të vendimit të shkallës së parë dhe të dytë të Inspektoratit të Punës. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe të anuloh vendimin me numër 01Nr.33-344/2020 të datës 06.07.2020 lëshuar nga organi i shkallës së parë në Inspektorat të Punës dhe Vendimi nr.prot. 410/20, të lëshuar nga organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës.

#### Kundërshtimet e të paditurës

Përfaqësuesi i të paditurës, nuk ka parashtruar përgjigje në padi. Padine dhe Aktvendimin për përgjigje ne padi i ka pranuar me date 29.01.2024.

#### Provat e administruara

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: vendimi me nr.Prot :586 i datës 07.04.2020 nga Bordi i Drejtorëve të KRU Prishtina, Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr. 01. Nr.33-344/2020 i datës 15.06.2020, Vendimi i Inspektoratit të Punës me Nr.Prot: IP.410/20 i datës 07.09.2020, si organ i shkallës së dytë.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga vendimi me nr.Prot :586 i datës 07.04.2020 nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të KRU Prishtina i është ndërprerë kontrata e Punës Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv Z. K.Xh. në KRU “Prishtina”, SH.A.

Nga Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr. 01. Nr.33-344/2020 i datës 15.06.2020, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e Z. K.Xh., ndërsa në pikën II është konstatuar se vendimi nr.Prot :586 i datës 07.04.2020 nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të KRU Prishtina është i bazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 21 par.21.4 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike në Kosovë.

Nga Vendimi i Inspektoratit të Punës me Nr.Prot: IP.410/20 i datës 07.09.2020, si organ i shkallës së dytë, është aprovuar si e bazuar ankesa e palës në procedurë Z. K.Xh., në pikën II është shfuqizuar vendimi i Inspektoratit të Punës, si organ i shkallës së parë 01Nr.33-344/2020 të datës 15.06.2020, në pikën III është anuluar vendimi Nr. 586 i datës 07.04.2020 i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Kompanisë Ujësjetillësi Rajonal “Prishtina” SH.A., duke lënë në fuqi vendimin Nr.554 të datës 02.04.2019.

Duke pas parasysh se shqyrtimi i pretendimeve për mungesë të kompetencës së Inspektoratit të Punës për nxjerrjen e vendimit të kontestuar është çështja kryesore dhe paraprake për vlerësimin e pretendimeve lidhur me vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata paraprakisht analizoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, respektivisht bazën ligjore për ta vlerësuar kompetencën e Inspektoratit të Punës.

Lidhur me vlerësimin e kompetencës së të paditurit Gjykata iu referua Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjit Nr. 03/L-017, Neni 2, ku përcaktohen funksionet e Inspektoratit të punës, që: a) *Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë b) Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore. c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm.*

*d) Do t’iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t’i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese. e) Do t’iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje, dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, i cili në nenin 3 përcaktuar: “Teksti të pika „a” e nenit 2 „ kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet më tekstin „Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë.”*

Gjykata i vlerësoi se pretendimet e paditësit kanë mbështetje në gjendjen faktike dhe janë në përputhje me provat e administruara në këtë çështje dhe dispozitat ligjore materiale që rregullojnë këtë çështje.

Sepse Gjykata vlerëson se vendimet kontestuese të paditurit, janë në nxjerrë nën tejkalim të kompetencave ligjore të cilat i ka Inspektorati i Punës, sepse sipas Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e punës nr. 2002/9 në asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet kompetenca e Inspektoratit të Punës për vendosje lidhur me të drejtat e të punësuarve nga marrëdhënia e punës. Por, sipas nenit 79 të Ligjit të Punës i cili përcakton se: *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.”* në rast se të punësuarit i janë shkelur të drejtat e tij me ndonjë vendim të punëdhënësit, i punësuarit mund që ti drejtohet gjykatës kompetente për shqyrtimin e pretendimeve të tij.

Në pajtim me Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, nenit 79 të Ligjit të Punës, por edhe sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ne rastin nr. K027/21, të datës 16 dhjetor 2022 Nr. ref.:AGJ 2098/22 për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 94 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me juridiksionin e Inspektoratit të Punës, në paragrafin 102 konstaton se: *[...] nuk rezulton te jete shkak i papajtueshmërisë se neni 94 të Ligjit të Punës me Kushtetutën, gjegjësisht me nenet 3, 24, 31, 49 dhe 54 të Kushtetutës, por rezultat i interpretimit dhe i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të nenit 94 të Ligjit të Punës dhe i Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, nga ana e Inspektoratit të Punës, dhe sipas paragrafit 104. ku konstaton se Ligji i Punës, Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për Siguri dhe Mbrojtje në punë, mandatojnë Inspektoratin e Punës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve në pajtim me fushëveprimin dhe funksionet e përcaktuara në nenin 1 dhe 2 të Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Por, as në dispozitat e këtij ligji, ligjeve të tjera dhe as nga gjuha e nenit 94 të Ligjit të Punës, nuk mund të kuptohet e as të nënkuptohet që një organ inspektues mund të përvetësojë funksione gjyqësore. Gjuha e normës kushtetuese është e qarte. Funksione gjyqësore mund të ushtrojnë vetëm gjykatat, sipas parimeve të përcaktuara me Kushtetute dhe ligjet përkatëse, edhe në rastin konkret kjo Gjykatë vlerëson se Aktvendimi i kundërshtuar është*

nxjerrë nga e Paditura Inspektorati i Punës si rezultat i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe si i tillë në mungesë të kompetencës ligjore për të vendosur lidhur me kërkesat e të punësuarve lidhur me të drejtat nga marrëdhënia e punës siç janë pagat, ligjshmëria e procedurave disiplinore, kthimi i punëtorëve në punë, shqyrtimi i ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kompensimet etj.

Sipas Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/09, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjit nr. 06/L-017 Inspektorati i Punës mund të shqiptojë masa ndëshkuese, respektivisht gjopa që i shqiptohen punëdhënësit në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.

Po ashtu, Neni 4 i Ligjit (nr.05/L-031) për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton kufizimin e që organet publike veprimtarinë tyre ta realizojnë brenda kompetencave të tyre. Në par. 1 të këtij neni është përcaktuar se: *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.* Gjithashtu neni 52 i LPPA përcakton se: *1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të neni 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë...*

Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se i padituri Inspektorati i Punës ka tejkaluar kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast, të gjykatës, dhe me nxjerrjen e vendimit të kontestuar, ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 par. 5 të Ligjit të Inspektoratit të Punës, par. 6 dhe 7 të Rregullores UA nr.07/2012 dhe nenin 70 par. 1.4 dhe 1.6 të Ligjit të Punës, andaj gjykata bazuar në nenin 46 par. 2 të LKA-së vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se provat e tjera të administruara janë relevante për vlerësimin e pretendimit të paditëses lidhur me vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike nga e paditura, por meqenëse u vërtetua kundërligjshmërisë e aktit të kontestuar për shkak të mungesës së kompetencën elaborimi i mëtejme i tyre është pa efekt në kundër ligjshmërinë e konstatuar të vendimit dhe si i tillë i panevojshëm.

Vendimi si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi u morë në bazë të neni 46 par. 3 dhe 4 të LKA-së i cili përcakton se: *3. Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin*

*administrativ të kontestuar. 4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.*

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.397/22, datë 21.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.